

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 190, datë 23.11.2017, “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, si më poshtë :
 - a. Neni 1 bëhet: Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga Enti Rregullator i Energjise, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” I ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, I ndryshuar.
 - b. Kudo në rregullore, togfjalëshi energjisë elektrike, bëhet energjisë.
 - c. Neni 3 bëhet : Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave rregullatore është, të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetim të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregtimit të gazit natyror, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.
 - d. Në nenin 4 shtohet pika 4.4 me përmbajtje: tregut të energjisë do të thotë tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror në kuptim të Ligjit nr. 43/2015 *Për sektorin e energjisë elektrike, I ndryshuar* dhe ligjit nr. 102/2015 *Për sektorin e gazit natyror, I ndryshuar*.
 - e. Neni 5, pika 5.1 ndryshon: Kjo Rregullore është konceptuar konform nenit 17 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar, ku parashikohet se:
 - f. Neni 5.4 ndryshon: Të licencuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 30 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar dhe të kushteve të licencës depozitojnë në ERE deri më datë 31 Janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datë 30 Qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullimit.
 - g. Neni 6.1 ndryshon: Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike të aktivitetit Rregullator të ERE-s, për çdo vit ushtrimor, për të ngarkuarit me shërbimin publik të realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licencuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.
 - h. Neni 6.2 ndryshon: Pagesa rregullatore për secilin të licencuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t’u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licencimi) të

përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- i. Neni 6.3 ndryshon: Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregimit të energjisë elektrike që në vitin parardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 100 mijë lekësh.
- j. Neni 9.1 ndryshon : Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 27 gërma ç të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar.
- k. Neni 9.2 ndryshon : Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundravajte administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 (b) nenit 107 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe pikës ii) të nenit 106 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.
- l. Neni 9.3 ndryshon: Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1. e 9.2 të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktuar në pikën 1 (ç) të nenit 42 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”.